REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SARANDË

PROJEKT-VENDIM

Nr.1, datë28.01.2026

"PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË KUSHTËZUAR PËR NDIHMËN EKONOMIKE DERI NË 6 % PËR MUAJIN DHJETOR 2025"

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 "Për Vetqeverisjen Vendore" neni 9 , neni 24 , Ligjit Nr 57/2019 "Për asistencen sociale në Republikën e Shqipërisë " , Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.597 datë 04.09.2019 "Përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar të ndihmës ekonomike" ,Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.868 datë 29.12.2021 "Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM 597 datë 04.09.2019", Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.617 datë 22.09.2022, Udhëzimi i Ministrisë së Mirëqënies Sociale dhe Rinisë nr.5 datë 17.02.2017 "Mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok- ndihmën ekonomike deri në 6 për qind" , Vendimi i Këshillit të Bashkisë Nr 6 date 30.01.2025 "Mbi miratimin e kritereve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën si dhe nga fondet e buxhetit vendor", me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak pasi analizoi relacionin e paraqitur:

V E N D O S I:

1. Miratimin e përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike deri në 6 për qind dhe trajtimin e 20 familje me një fond prej 73.267(*shtatëdhjetë e tre mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e shtatë*) lekë sipas listës nr.1 bashkëlidhur dhe konkretisht :
   Për Bashkinë Sarandë 19 familje me një fond 67.386 lekë.
   Për Njësinë Administrative Ksamil 1 familje me nje fond 5.881 lekë
2. Ngarkohen Drejtoria e Kujdesit Social dhe Drejtoria Ekonomike për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" dhe pas konfirmimit ligjor nga Prefektit i Qarkut Vlorë.

KRYETAR
Oltion ÇAÇI
Me urdhër delegim kompetencash
ZV/KRYETAR
Manjola NIKOLLO

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI BASHKIAK
SARANDË

PROJEKT-VENDIM

Nr.2, datë28.01.2026

"MBI DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE NGA TË ARDHURAT E BASHKISË PËR MUAJIN DHJETOR 2025"

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 "Për Vetqeverisjen Vendore" neni 9 , neni 24 , Ligjit Nr 57/2019 "Për asistencen sociale në Republikën e Shqipërisë " , Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.597 datë 04.09.2019 "Përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar të ndihmës ekonomike", Vendimi i Këshillit të Bashkisë Sarandë Nr 6 date 30.01.2025"Mbi miratimin e kritereve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën si dhe nga fondet e buxhetit vendor", Vendimi i Këshillit të Bashkisë Sarandë nr.73 datë 23.12.2024 "Mbi miratimin e Buxhetit të Bashkisë Sarandë për vitin 2025" me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak pasi analizoi relacionin e paraqitur:

V E N D O S I:

1. Të përfitojnë ndihmë ekonomike dhe mbeshtetje financiare nga të ardhurat e Bashkisë Sarandë për muajin Dhjetor 2025 në total për Bashkinë Sarandë dhe Njesinë Administrative Ksamil 52 familje me një fond 215.769 (*dyqind e pesedhjetëmije e shtatëqind e gjashtëdhjetë e nënte*) lekë dhe konkretisht:

Nr.	Njësitë Administrative	Nr.i familjeve	Shuma në lekë
1	Qendra e Bashkisë Sarandë	41	157.359
2	Njesia Administrative Ksamil	11	58.410

Familjet që do të përfitojnë në skemën e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin Dhjetor 2025 janë sipas listës bashkëlidhur.

Të mos trajtohen me ndihmë ekonomike familjet si më poshtë:
Qendra e Bashkisë Sarandë

Nr	Emër Atësi Mbiemër	Arsyet e daljes nga skema
1	Vero Riza Hoxha	Përmirësim i gjendjes ekonomike nëpërmjet punësimit
2	Manjola Laver Lika	Përmirësim i gjendjes ekonomike nëpërmjet punësimit

3	Jorgjia Nestor Kozllorof	Perfiton nga skema 6% e bllokskemës së NE
4	Bejushe Muhamet Matai	Perfiton nga skema 6% e bllokskemës së NE
5	Brunilda Zyfer Çela	Perfiton nga skema 6% e bllokskemës së NE

Të trajtohen për herë të parë me skemën e ndihmës nga të ardhurat

Njesia Administrative Ksamil

Nr.	Emër Atësi Mbiemër	Arsyet e hyrjes në skemë
1	Kristi Fatos Manolaj	Familje njëprinderore me probleme sociale

Rifuten ne skemën e ndihmës ekonomike në Bashkinë Sarandë 5 familje:

Nr	Emër Atësi Mbiemër	Arsyet e hyrjes në skemë
1	Agapi Ali Rustemi	Kryefamiljare grua, te ardhura te pamjaftueshme, pensioniste
2	Hanko Koçi Kordha	Kryefamiljare grua, te ardhura te pamjaftueshme, pensioniste
3	Marijana Koço Bubuçi	Kryefamiljare grua, te ardhura te pamjaftueshme, pensioniste
4	Liri Islam Muçodemi	Kryefamiljare grua, te ardhura te pamjaftueshme, pensioniste
5	Mariana Petref Ahmeti	Kryefamiljare grua, te ardhura te pamjaftueshme, pensioniste

2. Ngarkohen Drejtoria e Kujdesit Social dhe Drejtoria Ekonomike për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" dhe pas konfirmimit ligjor nga Prefektit i Qarkut Vlorë.

KRYETAR
Oltion ÇAÇI
Me urdhër delegim kompetencash
ZV/KRYETAR
Manjola NIKOLLO

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SARANDË

PROJEKT- VENDIM

Nr. 3 datë 28.01.2026

"PËR MIRATIMIN E KRITEREVE TË DHËNIES SË NDIHMËS EKONOMIKE NGA FONDI I KUSHTËZUAR PËR BLLOK-NDIHMËN SI DHE NGA FONDET E BUXHETIT VENDOR PËR VITIN 2026"

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 "Për Vetqeverisjen Vendore" neni 9 , neni 24 , Ligjit Nr 57/2019 "Për asistencen sociale në Republikën e Shqipërisë", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.597 datë 04.09.2019 "Përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar të ndihmës ekonomike" ,Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.868 datë 29.12.2021 "Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM 597 datë 04.09.2019", Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.617 datë 22.09.2022, Udhëzimi i Ministrisë së Mirëqënies Sociale dhe Rinisë nr.5 datë 17.02.2017 "Mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok- ndihmën ekonomike deri në 6 për qind", bazuar në relacionin e Drejtorisë së Kujdesit Social , Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë kriteret për përfitimin e nga skema e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok – ndihmën dhe nga skema e ndihmës ekonomike nga fondi i buxhetit vendor të familjeve të cilat kanë aplikuar më parë në sistem dhe nuk kanë përfituar për shkak te pikeve te pamjaftueshme dhe jane te varfëra, si më poshtë:

    a. Familje të cilat kanë aplikuar më parë në sistem dhe nuk kanë përfituar për shkak të pikëve të pamjaftueshme dhe janë familje në nevojë.
    b. Fëmije jetimë nga një ose të dy prinderit ose të braktisur.
    c. Familje me kryefamiljare femra që janë pragë pensioni (56 vjeç ose më shumë). dhe pa familjarë të afërm në vendbanim si dhe pensioniste të vetmuara kur masa e pensionit të tyre është e barabartë ose më e vogël se 16000 lekë/muaj.
    d. Familjë që kanë në përbërje anëtarë në moshë pune në kushte të varfërisë ekstreme.
    e. Familje me probleme të thella sociale që nuk mund të realizojnë proçeset gjyqësore për zgjidhje martese dhe / ose ka vendime gjyqësore për urdhër mbrojtje.
    f. Familje në nevojë që kanë në përbërjefëmijë që ndjekin universitetin.
    g. Familje që kanë në përbërje një ose më shumë anëtare me paaftësi/sëmundje të rënda të cilët janë përfitues të pagesave të paaftësie, si edhe në rastet kur nuk përfitojnë nga KMCAP-ja por janë në kushte të vështira social-ekonomike.
    h. Viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare edhe 3 muaj pas përfundimit të periudhës së vlefshmërisë se urdhrit të mbrojtjes, kur nuk kanë të ardhura ekonomike të mjaftueshme.
    i. Familje me nivel të ulët të ardhurave ekonomike , me nivel të ardhurash nga punëismi deri në vlerën 15.000 lekë për frymë.

j. Familjet të cilat janë skualifikuar nga sistemi i ndihmës ekonomike për shkak të mosazhornimit në kohë të tij e provuar me dokumentacion si dhe raport social për gjendjen e familjes si familje në nevojë.
k. Familje rome të varfra dhe/ose ekstremisht të varfera që kanë probleme me plotësimin e dokumentacionit.
l. Familje të cilat gjenden në kushte te një fatkeqesie të papritur, për një periudhë dymujore, deri sa te plotesojnë dokumentacionin përkatës dhe të kryhen verifikime të hollesishme (për të përfituar nga skema e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë)
m. Ne çdo rast dokumentacioni do të shoqërohet me raport social të përgatitur nga punonjësi social ose sipas rastit Njesia e mbrojtjes se fëmijve, Kordinatori kundër dhunës në familje etj.

2. Dokumentat e aplikuesve të jenë sipas VKM nr. 597 datë 4.09.2019 "Për përcaktimin e proçedurave, të dokumentacionit dhe masës mujore së përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike" ,të gjitha familjet do të trajtohen me ndihmë ekonomike pasi të jetë kryer paraprakisht vlerësimi socio-ekonomik në familje, masa e ndihmës ekonomike të llogaritet sipas VKM nr. 617 date 22.09.2022 "Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 597 datë 4.09.2019.
3. Përjashtohen nga përfitimi i ndihmës ekonomike, familjet që ne perberjen e tyre kanë qoftë edhe nje anetarë të familjes, që plotesojnë kushtet sipas percaktimeve sipas pikes 11) te VKM Nr 597 dt 04.09.2019 te ndryshuar. Për raste përjashtimore në bazë të raportit social familjes i kerkohen dokumentacion shtesë si, vërtetim shkolle për anëtarët e familjes që ndjekin arsimin e mesëm apo të lartë, vertetim ushtrie, vërtetim nga sistemi TIMS për hyrje-dalje jashtë shtetit, vërtetim nga institucione shëndetësore etj.
4. Ngarkohet Drejtoria e Kujdesit Social dhe Drejtoria e Financës për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" dhe pas konfirmimit ligjor nga Prefektit i Qarkut Vlorë dhe do të fillojë efektet e tij prej muaj Shkurt 2026.

K R Y E T A R
Oltion ÇAÇI
Në mungesë dhe me porosi
ZV/KRYETAR
Manjola NIKOLLO

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SARANDË
KËSHILLI I BASHKISË SARANDË

PROJEKT- VENDIM

Nr. 4 datë 28.01.2026

"PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI SUBVENCIONIMIT TË QIRASË NË TREGUN E LIRË"

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore" nenin 8,pika 2, nenin 9, pika 1 dhe 1.1, shkronja "b", nenin 24 pika 2, ligjit nr 22/2018 "Për Strehimin Social", i ndryshuar ligjit nr. 48/2023 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 22/2018", Ligjit 139/2015 datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", neni 8 pika 2 dhe neni 9 pika 1.1 b dhe neni 24 pika 2 , si dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.384 datë 12.06.2019 "Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim, sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të proçedurave të miratimit nga organet e vetqeverisjes vendore" dhe në VKM Nr.362 datë 29.05.2019 "Për kriteret e dhënies së subvencionimit të qerasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij",Vendimin e Komisionit të Strehimit nr.1 datë 15.01.2024 , bazuar në relacionin e Drejtorisë së Kujdesit Social , Këshilli i Bashkisë Sarandë,

VENDOSI:

1. Të miratojë listën e familjeve përfituese nga programi për "*Subvencionimit të qirasë në tregun e lirë*" dhe vlerave mujore përkatëse sipas tabelës 1 bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Ngarkohet Drejtoria e Kujdesit Social dhe Drejtoria e Financës për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" dhe pas konfirmimit ligjor nga Prefektit i Qarkut Vlorë.

KRYETAR
Oltion ÇAÇI
Me urdhër delegim kompetencash
ZV/KRYETAR
Marjola NIKOLLO

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SARANDË

PROJEKT-VENDIM

Nr. 5 datë 28.01.2026

"PËR MIRATIMIN E LISTËS EMËRORE TË NXËNËSVE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR NË INSTITUCIONET ARSIMORE PUBLIKE QË DO TË PËRFITOJNË BURSAT FINANCIARE PËR VITIN SHKOLLOR 2025-2026"

Mbështetur në Ligjin nr. 139/2015 datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore" , të nenit 19, të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.666 datë 10.10.2019 " Për kuotat finaciare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kritereve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike" ndryshuar , Shkresën nr.7094 prot. datë 06.11.2025 e Ministrisë së Arsimit mbi dërgimin e numrit të bursave për nxënësit të cilët ndjekin studimet në institucioneve arsimore publike të arsimit parauniversitar për vitin shkollor 2025-2026, Shkresën nr.973/1 prot. datë 29.10.2025 e Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit mbi dërgimin e numrit të bursave për nxënësit të cilët ndjekin klasnë e 10 -të në shkollat e mesme të arsimit profesional publik për vitin shkollor 2025-2026, bazuar në relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Arsimit dhe Administrimit Financiar, Këshilli i Bashkisë Sarandë,

VENDOSI:

1. Të miratojë listën emërore të nxënësve të arsimit parauniversitar në institucionet arsimore që do të përfitojnë bursat financiare sipas tabelës bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Ngarkohet Drejtoria e Arsimit dhe Administrimit Financiar dhe Drejtoria e Financës për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" dhe pas konfirmimit ligjor nga Prefektit i Qarkut Vlorë.

KRYETAR
Oltion ÇAÇI
Me urdhër delegim kompetencash
ZV/KRYETAR
Manjola NIKOLLO

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SARANDË

PROJEKT-VENDIM

Nr. 6, datë 28.01.2026

"PËR MIRATIMIN E PËRDORIMIT DHE PLANIN TË SHPËRNDARJES SË FONDIT TË GRANTI TË BAZUAR NË PERFORMANCË TË BASHKIVE PËR VITIN 2025 "

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 "Për Vetqeverisjen Vendore" i ndryshuar, Ligjin 9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republijën e Shqipërisë " i ndryshuar Ligji nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" i ndryshuar, Udhëzimi i përbashkët të Ministrisë së Financave dhe Ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor nr.01 datë 11.072025 "Për kriteret, procedurat , treguesit për shpërndarjen e fondit të grantit të bazuar në performancë për bashkitë për vitin 2025" , bazuar në relacionin e paraqitur, Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI:

1. Miratimin e përdorimit të fondit të përfituar nga Granti bazuar në performancën e bashkive për vitin 2025 dhe planin e shpërndarjes së tij sipas aneksit 1 bashkëlidhur dhe pjesë përbërese të këtij vendimi.
2. Ngarkohet Bashkia Sarandë për ndjekjen e procedurave të përcaktuara në Udhëzimi i përbashkët të Ministrisë së Financave dhe Ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor nr.01 datë 11.072025 "Për kriteret, procedurat , treguesit për shpërndarjen e fondit të grantit të bazuar në performancë për bashkitë për vitin 2025" .
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" dhe pas konfirmimit ligjor nga Prefektit i Qarkut Vlorë.

KRYETAR
Oltion Çaçi
Në mungesë dhe me porosi
ZV/KRYETAR
Florjan Sali

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA SARANDË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SARANDË

PROJEKT-VENDIM

Nr. 7, datë 28.01 2026

"PËR MIRATIMIN E NJË NDRYSHIMI NË FUSHËN E PËRDORIMIT TË PASURISË 15/609 ME SIPËRFAQE 9200 M² DHE PASURISË 15/610 ME SIPËRFAQE 10810 M2, ZONA KADASTRALE 8642 "TRUALL", NË PRONËSI TË BASHKISË SARANDË, DUKE SHTUAR FUSHËN E PËRDORIMIT PËR ZHVILLIMIN E PROGRAMEVE TË ARSIMIT PARAUNIVERISTAR DHE ZHVILLIMIN E PROJEKTIT "POLI I ZHVILLIMIT TURISTIK SARANDË"

Bazuar në nenin 8, pika 2, nenin 9, pika 1, nënpika 1.1, gërma "b", nënpika 1.1, shkronja "a" "c", nenin 23, pika 11, nenin 54, nenin 55, pika 2 dhe 6 të ligjit nr. 139, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar; ligjin nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit" të ndryshuar; ligjin nr. 8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore" të ndryshuar, Vendim e Këshillit të Ministrave nr. 297, datë 20.4.2016 për kalimin në pronësi, nga drejtoria e shërbimeve qeveritare te bashkia sarandë, të pronës me emërtimin "rezidencë qeveritare", me vendndodhje në zonën kadastrale 8642, sarandë, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 1058, datë 16.7.2008, të këshillit të ministrave, "për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi këshillit të ministrave, për drejtorinë e shërbimeve qeveritare' , Vendimin e Këshillit të Minstrave nr.235, datë 23.3.2011 për kalimin në pronësi, të bashkisë sarandë, të sipërfaqes 9200 m², nga trualli funksional i pronës nr.206 "rezidenca qeveritare sarandë", për një ndryshim në vendimin nr.1058, datë 16.7.2008 "për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi këshillit të ministrave, për drejtorinë e shërbimeve qeveritare", të ndryshuar, dhe për një ndryshim në vendimin nr.20, datë 9.1.2008 të këshillit të ministrave "për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të bashkisë sarandë të qarkut të vlorës,Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.71 datë 30.05.2025 "Për miratimin marrëveshjes së bashkëinvestimit ndërmjet fondit shqiptar të zhvillimit dhe bashkisë sarandv me objekt: "projektimi, ndërtimi, administrimi dhe menaxhimi i qëndrueshëm i projektit "poli i zhvillimit turistik në sarandë ", Këshilli Bashkiak pasi analizoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Projekteve, Turizmit dhe Integrimit Europian, Drejtoria Juridike dhe Drejtoria e Arsimit dhe Administrimit Financiar:

VENDOSI:

1. Miratimin e shtesës se funksionit të përdorimit të pasurisë e llojit truall me nr.15/609 me sipërfaqe e truallit prej 9200 m², pasuri në pronësi të Bashkisë Sarandë, duke shtuar në fushën e përdorimit të saj dhe " *zhvillimin e programeve parauniversitare* ".

.. Miratimin e shtesës se funksionit të përdorimit të pasurisë e llojit truall me nr.15/610 me sipërfaqe e truallit prej 10810 m^2 , pasuri në pronësi të Bashkisë Sarandë, duke shtuar në fushën e përdorimit të saj dhe "*funksioneve të tjera sipas ligjit*" referuar neni 3 pika k të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore" të ndryshuar, zhvillimin e projektit "*Poli i Zhvillimit Turistik Sarandë*".

3. Bashkia Sarandë të marrë të gjithë masat e nevojshme për vijimin dhe ndjekjen e procedurës administrative për ndryshimet e caktuara në pikën 1 dhe 2 të destinacionit referuar parashikimeve ligjore në fuqi.
4. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Projekteve, Turizmit dhe Integrimit Europian, Drejtoria Juridike, dhe Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit.
5. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" dhe pas konfirmimit ligjor nga Prefektit i Qarkut Vlorë.

KRYETAR
Dhion ÇAÇI
Në mungesë dhe me porosi
ZV/KRYETAR
Elorjan SALI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SARANDË